



Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike - SLAPP

Çfarë janë procedurat SLAPP?

Procedurat gjyqësore abuzive kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) janë procese gjyqësore që nuk ndërmerren për të mbrojtur një të drejtë, por për të parandaluar, kufizuar ose ndëshkuar pjesëmarrjen publike.

Ato shpesh shfrytëzojnë pabarazitë e pushtetit ndërmjet palëve dhe mbështeten në pretendime të pabazuara.

Tregues të një qëllimi të tillë përfshijnë:

- (a) natyra joproporcionale, e tepruar ose e paarsyeshme e kërkesës ose e një pjese të saj;
- (b) ekzistenca e procedurave të shumta të nisura nga paditësi;
- (c) frikësimi, ngacmimi ose kërcënimet nga ana e paditësit ose përfaqësuesve të tij, para ose gjatë procedurës;
- (d) përdorimi në keqbesim i taktikave procedurale, si vonesa e qëllimshme e procedurave, zgjedhja mashtroese ose abuzive e juridiksionit, apo ndërprerja e çështjeve në një fazë të mëvonshme të procedurës në keqbesim.

Çfarë është pjesëmarrja publike?

Pjesëmarrja publike nënkupton çdo deklaratë apo veprimtari nga persona fizikë ose juridikë në ushtrimin e të drejtës për:

- Liri shprehjeje dhe informimi;
- Liri arti dhe shkencash;
- Liri tubimi dhe shoqërimi;

si dhe çdo veprim mbështetës apo ndihmës të lidhur drejtpërdrejt me këto të drejta dhe që lidhet me një çështje me interes publik.



Çfarë është një çështje me interes publik?

Çështje me interes publik nënkupton çdo çështje që ndikon publikun në një masë të tillë sa që publiku mund të ketë legjitimisht interes për të. Kjo përfshin fusha si:

(a) të drejtat themelore, shëndeti publik, siguria, mjedisi dhe klima;

(b) veprimtaritë e figurave publike në sektorin publik apo privat;

(c) çështjet që shqyrtohen nga institucione legislative, ekzekutive ose gjyqësore;

(d) rastet e dyshuara për korrupsion, mashtrim apo shkelje administrative;

(e) veprime që mbrojnë vlerat themelore të Bashkimit Evropian, përfshirë luftën kundër dezinformimit dhe ndërhyrjeve të pajustificuara në proceset demokratike.

**Informacioni i përfshirë në këtë fletëpalosje është marrë nga Direktiva e BE-së (2024/1069) dhe Rekomandimi CM/Rec(2024)2 i Këshillit të Evropës.*

Si të njohim një SLAPP?

- ✦ Shfrytëzimi i avantazhit financiar, politik ose shoqëror për të ushtruar presion;
- ✦ Argumente të pabazuara;
- ✦ Kërkesa joproporcionale apo të paarsyeshme;
- ✦ Abuzim me ligjin apo procedurat gjyqësore;
- ✦ Taktika për të rritur kostot dhe vonuar procedurat;
- ✦ Synimi i individëve në vend të organizatave;
- ✦ Intimidim, ngacmim apo kërcënime ligjore;
- ✦ Veprime të shumta dhe të koordinuara në disa juridiksione;
- ✦ Refuzimi për të përdorur mekanizma jashtëgjyqësorë për zgjidhje.

Pse është e rëndësishme të njohim SLAPP-et?

SLAPP-et minojnë demokracinë dhe lirinë e shprehjes, duke i kthyer mjetet ligjore në armë për të heshtur gazetarë, aktivistë, organizata dhe qytetarë të angazhuar. Njohja dhe identifikimi i tyre është hapi i parë drejt mbrojtjes së pjesëmarrjes publike dhe garantimit të një hapësire të lirë demokratike.

**Kjo fletëpalosje është përgatitur në kuadër të projektit "Western Balkans Civil Society Development Hub", i financuar nga Sida dhe i zbatuar nga BCSDN. Përmbajtja e këtij dokumenti dhe informacionet e pikpamjet e prezantuara nuk përfaqësojnë qëndrimin dhe opinionin zyrtar të Sida dhe BCSDN. Përgjegjësia për informacionin dhe qëndrimet e shprehura në këtë fletëpalosje i përket Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.*

Na kontaktoni:



+355697889600



partners@partnersalbania.org



Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10, ap. 71/73, Tiranë.

